



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
 OpštinaSkupština Rahovac/Municipality of Rahovec



P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më datë **15.11.2024**, me fillim në orën **10:35**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete, **Bajram Morina**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Faleminderit për praninë tuaj! Përshëndetje për drejtorin e Arsimit, Avni Morina. Përshëndetje për zyrtarin policor, përfaqësuesit e KFOR-it, të OSBE-së, shefin e ZKKK-së, Lendrit Qelin, anëtarët e komitetit dhe të gjithë të pranishmit. Ky është takimi i **pestë** për vitin 2024, për takimin e sotëm, i kemi këto pika të rendit të ditës:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë nga stacioni policor në Rahovec, rreth gjendjes së sigurisë te komuniteti joshumicë në Komunën e Rahovecit;
3. Informatë nga DKA-ja për regjistrimin e fëmijëve të komunitetit joshumicë për procesin mësimor 2024-2025 – gjendja e regjistrimit, pengesat në regjistrim, braktisja e mësimi;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi: Atëherë, ky është rendi i ditës për sot. Po e vendosim në votim si të tillë. Kush është “për”?... Me shumicë unanime aprovohet rendi i ditës.

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Informatë nga stacioni policor në Rahovec, rreth gjendjes së sigurisë të komunitetit joshumicë në Komunën e Rahovecit:

Avni Paqarizi: Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit! Situata e sigurisë në komunën tonë është e qetë dhe stabile, bazohet në ligjet aktuale në fuqi, në strategji, në urdhra operative, plane operative, plane të veprimit dhe detyra të zakonshme në bazë të kërkesave të qytetarëve. Gjendja e sigurisë vazhdon të jetë e qetë edhe në zonat ku janë të banuara me qytetarë të komunitetit joshumicë. Nuk kemi ndonjë rast që ndikon në prishjen e ruajtjes së rendit dhe të qetësisë publike në komunën e Rahovecit. Ka ndodhur një rast “person i zhdukur” dhe pastaj është gjetur, një tjetër rast është dhunë në familje, 1 rast të bashkësisë jashtëmartesore nën moshën 16-vjeçare dhe 1 rast posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge. Problem i theksuar vazhdon të jetë që disa të mitur lejohen nga prindërit për të kërkuar lëmshë.

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë! Raporti i policisë nuk e di se për çfarë kohe është, por, u përmend që është veç një raportim i dhunës në familje. Në këtë kohë, mendoj që është rritur vetëdijesimi për raportim. Më çudit fakti pse kaq pak raportime, uroj që mos të ketë asnjëherë, por, a mendoni që ka mungesë të vetëdijesimit për raportim të komunitetit joshumicë, apo me të vërtetë mendoni që nuk ka më shumë raste të dhunës në familje?

Avni Paqarizi: Për komunitetet joshumicë është i raportuar veç një rast. Në përgjithësi ka raste më shumë. Është rritur vetëdijesimi i viktimave dhe gjithashtu është rritur besimi në institucione, si në polici, në QPS, apo në prokurori.

Ramë Berisha: Përshëndes të gjithë pjesëmarrësit, udhëheqësinë, përfaqësuesin e OSBE-së, organet e sigurisë! Anëtarët e Komitetit për Komunitete mbledhemi në këtë bashkësi për të dhënë informata për raste të ndryshme të kësaj shoqërie. Ne, si mekanizëm lokal, jemi të obliguar për përmirësimin e rasteve në të mirën e qytetarëve. Komuna jonë ka kontribuar në shëndetësi, në arsim, në bujqësi dhe në infrastrukturë, në rrugë dhe në ndriçim. Në Ratkoc dhe në Xërxë, ka ende lagje që nuk kanë ndriçim, por, jemi me shpresë që do të përfundojë edhe aty. Duhet të kemi durim, siç është fjala popullore “Sabër selameti”.

Dusan Stojanovic: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! E përshëndes edhe komandantin prezent, i cili na informoi me raportin e tij! E kam një pyetje: me sa jam informuar, para dy viteve është planifikuar të hapet një konkurs për punësimin e një punëtori në stacionin policor, për t’i pranuar thirrjet telefonike në gjuhën serbe. Ka ndodhur rasti që gjatë thirrjeve që i kemi bërë, zyrtari që është lajmëruar nuk e ka njohur gjuhën serbe dhe është dashur të presim 3-5 minuta deri sa të rregullohet kjo çështje. Si është gjendja tani?

Avni Paqarizi: Unë jam duke e përfaqësuar komandantin! Nuk jam në dijeni rreth këtij projekti, mirëpo një pjesë bukur e madhe e personalit që punon në radio-bazë e njohin gjuhën. Ndodh ndonjëherë që zëvendësohen dhe mund të krijohen edhe këto pritje të vogla.

3. Informatë nga DKA-ja për regjistrimin e fëmijëve të komunitetit joshumicë për procesin mësimor 2024-2025 – gjendja e regjistrimit, pengesat në regjistrim, braktisja e mësimi:

Avni Morina: Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete, përfaqësues të KFOR-it, të OSBE-së! Në komunën tonë funksionojnë dy qendra arsimore për fëmijët e komunitetit joshumicë. Njëra menaxhohet nga Drejtoria Komunale për Arsim, e cila është themeluar para 3 vitesh. Tjetra menaxhohet nga Qendra Rinore - SHL “Kosova”. Të dyja qendrat janë të vendosura me bazë në shkollë. Në Ratkoc janë të angazhuar 2 mësimdhënës mbështetës, të cilët fëmijëve të komuniteteve dhe jo vetëm, u mbajnë çdo ditë mësim plotësues. Në Rahovec, qendra që është në shkollën “Gëzim Hamza – Piktori”, menaxhohet sipas marrëveshjes nga SHL “Kosova”. Aty është e angazhuar një mësimdhënëse e kualifikuar, ku marrin pjesë rreth 40 nxënës të komuniteteve joshumicë. Dua t’ju jap disa të dhëna kryesisht për qendrën mësimore që menaxhohet nga Drejtoria Komunale për Arsim. Në këtë qendër janë 2 mësimdhënës mbështetës, Bajram Morina dhe Nexhmije Hoti, të cilët kanë kontratë të lidhur deri në fund të vitit 2025, me mundësi vazhdimi në bazë të marrëveshjes që do të bëhet në mes të DKA-së dhe të MASHT-it. Në fillim të këtij viti shkollor, në këtë qendër janë të regjistruar 27 fëmijë, që i përkasin moshave dhe gjinive të ndryshme. 13 fëmijë janë nga komunitetet pakicë, 14 janë nga komunitetet shumicë. E mira e kësaj qendre është që ka edhe fëmijë të komunitetit shumicë, por që emërues të përbashkët e kanë ngecjen në mësimnxënie gjatë procesit mësimor. Këta fëmijë janë po ashtu edhe nxënës të rregullt të shkollës dhe mësimin plotësues e mbajnë jashtë orarit të rregullt mësimor. Mësimdhënësit që janë duke punuar aty, kanë bërë një punë të çmuar në identifikimin e rasteve që kanë nevojë për mësim plotësues. Në Ratkoc janë 11 femra dhe 16 meshkuj; 19 prej tyre janë nga klasa e parë deri në të pestën dhe nga klasa e gjashtë deri te e nënta, janë 8 fëmijë, gjithsej 27. Mësimdhënësit e kësaj qendre arsimore, përveç që kanë komunikim të mirë me personelin tjetër të shkollës, janë gjithashtu edhe pjesë e ekipit për parandalimin e braktisjes së shkollës. Ky ekip ka bërë disa përpjekje përmes vizitave në familje, përmes komunikimit me prindër dhe kanë arritur që në këtë fazë t’i rikthejnë 3 nxënës të komunitetit pakicë në shkollë. Në këtë raport janë paraqitur temat që janë trajtuar dhe rezultatet e arritura. Te bashkëpunimi me prindër, temë e bisedës është vijueshmëria e rregullt në qendër arsimore të mësimi plotësues dhe në shkollë. Është një rast për një nxënës, para se të merren me këtë rast, nxënësi nuk ka ditur të shkruajë me shkronja të dorës edhe pse është në klasë të dytë. Si rezultat i angazhimit të këtyre mësimdhënësve mbështetës në mësimin plotësues, ky nxënës ka arritur që sot të ketë një shkrim shumë të mirë me shkronja të dorës ose të shkrimit. Një e arritur tjetër e madhe është numri i rasteve të rikthimit në

shkollë, pas braktisjes së shkollës. Janë tri raste dhe konsiderohet sukses, sepse ka kohë që nuk kemi pasur rikthim. Ju përgëzoj! Në fund, ju informoj se të gjitha shkollat dhe çerdhet e komunës sonë janë furnizuar me lëndë djegëse – ngrohëse për dimër.

Faton Ramadani: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Drejtor, faleminderit për informatën që na dhe për fëmijët e komunitetit joshumicë dhe që u zgjerove pak më shumë edhe për komunitetet e tjera! Pikën e orientuar më shumë te dy qendrat arsimore që janë me bazë në shkolla, në Ratkoc dhe në Rahovec. Mendoj që qendrat janë të nevojshme dhe me rëndësi, por ka edhe fshatra të tjera që kanë fëmijë të komunitetit joshumicë që ballafaqohen me probleme të ndryshme, si braktisje apo mungesa të shumta në mësim. Mendoj që duhet të merrni masa dhe ju jeni personi në vijë të parë për këtë punë. I kam disa pyetje: Komunitat pak a shumë kanë marrë vendim për këtë doracakun për edukimin seksual dhe shëndetin riprodhues, vendimi është që mos të aplikohet. Ju ende nuk keni bërë asgjë deri tani, përveç një reagimi të kryetarit të komunës. Cili është opinion juaj për këtë punë? Tjetra, shumica e shkollave të komunës së Rahovecit kanë probleme me fotokopjues dhe mendoj që duhet ta zgjidhni këtë punë. Fotokopjuesi kryesor ku punoj unë, një muaj punon, dy të tjera jo. Planet javore, tekstet, testet dhe punimet e ndryshme nuk kemi ku t'i fotokopjojmë. Fatmirësisht, këtë vit janë furnizuar shkollat me lëndë djegëse dhe është shumë mirë që keni vepruar më herët. Në çerdhen në Xërxë është paraqitur një problem, aty kanë problem me nxemjen dhe besoj që duhet të intervenoni.

Kryesuesi: Sa i përket braktisjes nëpër shkollat e tjera, kemi realizuar vizitat nëpër shkolla në bazë të planit vjetor. Në Ratkoc, në Rahovec, në Xërxë dhe në Fortesë. Në bazë të të dhënave zyrtare, kemi pasur tri braktisje, të cilat kemi arritur t'i rikthejmë në shkollë.

Faton Ramadani: Është e vërtetë që i kemi bërë vizitat. Drejtorët kanë thënë që procesi po shkon mirë, mirëpo, ne jemi të vetëdijshëm që komuniteti pakicë mungon shumë, kanë mungesa të shumta.

Avni Morina: Në raportin që e prezantova para jush, u fokusova në dy qendra, sepse aty ka më shumë fëmijë të komuniteteve pakicë. Është e vërtetë që edhe në shkolla të tjera ka fëmijë të komuniteteve pakicë, por, ata janë të integruar në klasa të rregullta me fëmijët e komunitetit shumicë. Është e vërtetë që komuniteti pakicë bën mungesa më shumë, por, deri më tani nuk kemi pranuar raporte që ka pasur braktisje, prej shtatorit deri më tani. Mos të harrojmë që në çdo shkollë duhet të funksionojë edhe ekipi për parandalimin e braktisjes, sepse nëse nuk funksionon siç duhet, një pjesë të fajit e keni edhe ju, unë dhe ai tjetri. Për problemet me fotokopje: Fillimisht do të bëhet një hulumtim nëpër shkolla dhe shumë shpejt do ta lidhim një kontratë për t'i pajisur të gjitha shkollat me fotokopjues. Nga operatori i kontraktuar, dje është zgjidhur problemi me ngrohje në çerdhen e Xërxës. Të njëjtin problem e kemi pasur në Ratkoc edhe në Krushë. Në Ratkoc, për shkak të problemit me rrymë, ende nuk është zgjidhur problemi, pritet ditëve në vijim të zgjidhet, ndërsa në Krushë të Madhe është kryer. Sa i përket doracakut për edukimin seksual, ne nuk pajtohemi. Kryetari e ka bërë një reagim dhe natyrisht që ne nuk jemi kundër që edukimi seksual të zhvillohet për moshën e duhur, zakonisht në shkolla të mesme, siç ka qenë në të kaluarën dhe jo për fëmijët prej klasës së parë, deri në të pestën. Këta doracakë nuk ofrojnë asgjë tjetër, veçse çoroditje. Të marrim vendim? Nuk e di a kam kompetencë si Drejtori e Arsimit të marr vendim, por reagimi ynë është refuzues. Në vend se t'ju mësohen gjërat e tjera: pse bie shi? pse borë? pse breshër? pse shkrepëtin vetëtima? -Ata u fusin në kokë degjenerimin. Meqenëse nuk jam jurist, nuk dua të parashikoj se a do të dalim me vendim, apo jo. Kryesorja është që jemi kundër përmbajtjes që ofrojnë ata doracakë.

Merisa Sharku: Faleminderit drejtorit për informatë! Me sa e kuptova që vetëm tre fëmijë e kanë braktisur shkollën. Në anën tjetër, gjendja faktike në terren nuk duket shumë reale. A ka informata për gjendjen faktike se sa fëmijë nuk vijnë në mësimin, sa fëmijë nuk e kanë filluar fare?

Avni Morina: Kjo çështje shtrohet në dy aspekte. Nëse bëhet fjalë për numrin e fëmijëve që nuk e vijnë në mësimin, nënkuptojmë që ata fëmijë kanë qenë të regjistruar në shkollë, mirëpo gjatë kohës e kanë ndërprerë procesin mësimor. Nëse bëhet fjalë se sa fëmijë nuk e kanë filluar shkollën fare, ne si drejtori nuk mund ta dimë. Qendra e regjistrimit mund të jetë në dijeni për këto gjëra, në bazë të moshës. Ne kemi të dhëna kur bëjnë

mungesa, të cilat shkojnë në funksion të braktisjes së shkollimit. Mësimdhënësit edhe kujdestarët i përcjellin për çdo ditë numrin e mungesave. Këto të dhëna i posedojmë.

Kryesuesi: Nëse një fëmijë mbi moshën shtatë-vjeçare nuk e vijon procesin mësimor dhe në këtë rast prindi është rast social, automatikisht atij i kërkohet vërtetimi nga shkolla, në mënyrë që të kuptohet nëse fëmija i tyre është duke vijuar mësimin apo jo.

Merisa Sharku: Për këtë arsye duhet të ekzistojë lidhshmëria ndërmjet institucioneve. Në këtë rast, DKA-ja duhet të bashkëveprojë me institucionin e qendrës së regjistrimit dhe të shikojë se sa fëmijë të komuniteteve e arrijnë moshën për ta vijuar shkollimin dhe t'i stimulojnë ata për ta filluar procesin mësimor.

Faton Ramadani: Drejtor, shkollat kanë problem edhe me nxënësit të cilëve prindërit u jetojnë jashtë. Nxënësit shkojnë jashtë ndoshta edhe pa e njoftuar mësimdhënësin dhe nuk kthehet 2-3 javë. Nuk e di, ndoshta edhe nuk kemi ndonjë formë se si ta ndalojmë këtë fenomen shqetësues. Tjetra, më duket se shumë po u jepni leje mësimdhënësve si DKA për të dalë jashtë vendit, në Amerikë, në Gjermani etj... Nëse keni ndonjë informatë më të hollësishme, pse?

Avni Morina: Megjithëse është jashtë rendit të ditës ky diskutim, por, ne kemi disa raste që janë jashtë vendit dhe ata kanë marrë pushim pa pagesë. Mësimdhënësja e shkollës "Isa Boletini" është në Amerikë dhe ka shkuar ta vizitojë vajzën, e cila ka marrë pushim pa pagesë, që është e drejtë ligjore e saj sipas ligjit të punës. Nëse Fatoni ka të dhëna që ndonjë mësimdhënës ka shkuar pa leje të DKA-së, atëherë ne do të marrim masa. Ndërsa, për nxënësit që kërkojnë të shkojnë për 2-3 javë, i kam pasur dy raste që ka ardhur familja të kërkojë leje dhe ia kam dhënë, sepse jemi njerëz.

Faton Ramadani: Unë nuk thashë që mësimdhënësit po shkojnë jashtë pa leje. Mendoj që DKA-ja është duke dhënë shumë leje që ata të shkojnë jashtë. Nxjerrin vërtetime të ndryshme te mjekët e tyre, sa për t'i arsyetuar te ju. Për këto gjëra më vjen shumë keq.

4. Të ndryshme:

Dusan Stojanovic: Një pyetje për shefin e ZKK-së, Lendrit Qelin, lidhur me kanalizimin i cili është ndërtuar në Lagjen e Epërme. Kanalizimi ka pësuar dëmtime të vogla, pas kësaj është riparuar, por, kubëzat nuk janë vendosur mirë. K.R.U. "Gjakova" ka thënë që ne nuk jemi kompetentë për rikthimin e gjendjes së mëparshme. Kujt duhet t'i drejtohem për këtë çështje?

Lendrit Qeli: Faleminderit! Ne si zyrë nuk e kemi këtë informatë. Për kanalizim e dini që kemi intervenuar, është bashkëpunim mes komunës dhe K.R.U. "Gjakova". Ju mund ta bëni një kërkesë përmes zyrës tonë dhe Drejtorisë për Shërbime Publike, në mënyrë që ta shohim se si mund të intervenojmë. Gjendja e ngjashme është edhe në fshatin Krushë, sidomos te vendbanimi i komunitetit joshumicë. Prej vërshimeve atje ka ndodhur një plasaritje dhe pretendojmë që gjatë vitit të ardhshëm, me mjetet tona, ta shohim mundësinë e intervenimit.

Kryesuesi: Faleminderit, Lendrit! Nëse nuk ka edhe dikush diçka tjetër, po e përfundojmë mbledhjen e sotme. Shihemi në mbledhjet e radhës!

Mbledhja përfundoi: 11:10

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

Kryesuesi i mbledhjes:

Bajram Morina

